



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BERAT

Berat më \_\_\_\_/\_03\_/2024

**RELACION**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR. 60 DATË 21.12.2023 "PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË BERAT PËR VITIN 2024 DHE PBA 2024-2026 " i ndryshuar ( për miratimin e financimit të projektit "Ndërtim i shkollës 9-vjeçare "22 Tetori" Berat dhe ambienteve të shërbimit dhe prishja e objektit ekzistues të shkollës "22 Tetori" )**

Të nderuar këshilltarë !

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 54, gërma "dh", neni 64 gërma "c", ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar , të ligjit nr. 97/2023 "Për Buxhetin e vitit 2024", Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Udhëzimit plotësues nr. 1 datë 24.01.2024 të Ministrit të Financave "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024"; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr 60 datë 21.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat të vitit 2024 dhe PBA 2024-2026" i ndryshuar, shkresës së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr 1815/3 dt. 11.03.2024 " Njoftim për shpalljen fitues të projekteve të aplikuara pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për objekte shkollore të arsimit parauniversitar dhe programit për sportin" ,

propozojmë që në VKB nr 60 datë 21.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat të vitit 2024 dhe PBA 2024-2026" i ndryshuar , të bëhet rishpërndarje e fondeve në buxhetin e vitit 2024 si edhe në PBA 2024-2026.

Bashkia Berat është shpallur fituese për projektin "Ndërtim i shkollës 9-vjeçare "22 Tetori" Berat dhe ambienteve të shërbimit dhe prishja e objektit ekzistues të shkollës "22 Tetori" nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (informacioni më i detajuar ju është paraqitur në materialin lidhur me këtë projekt).

Vlera totale e projektit është 442,834,0.06 lekë, nga të cilat Ndërtimi i shkollës "22Tetori" 377,010,396 Lekë dhe ndërtimi i ambienteve të shërbimit 65,823,701.06 lekë.

Ndërtimi i shkollës "22 Tetori" do të bashkëfinancohet nga Ministria e Arsimit & Sporteve dhe nga Bashkia Berat në raportin 70/ 30. Përkatësisht :

- 263,907,277 lekë nga MAS , ose 70 % e vlerës së projektit
- 113,103,119 lekë nga Bashkia Berat, ose 30 % e vlerës së projektit

Gjithashtu Bashkia Berat financon me 65,823,701.06 lekë për ndërtimin e ambienteve të shërbimit. Shuma totale e financimit nga Bashkia Berat për këtë projekt është 178,926,820.06 lekë.

Projekti pritet të zbatohet në më shumë se nje vit, dhe po kështu do të jetë edhe financimi i punimeve të kryera.

Ministria e Arsimit dhe Sportit do të kryejë financimin në dy vite buxhetore, konkretisht:

- financimi i vitit 2024 do të jetë 120,000,000 lekë, dhe
- financimi i vitit 2025 do të jetë 143,907,277 lekë.

Bashkia Berat do të financojë objektin në vitet 2024-2026 :

- financimi i vitit 2024 do të jetë 25,000,000 lekë
- financimi i vitit 2025 do të jetë 80,000,000 lekë
- financimi i vitit 2026 do të jetë 73,926,820.06 lekë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT**

Është e nevojshme të bëhen ndryshime në buxhetin e vitit 2024 dhe PBA 2024-2026, duke rishpërndarë fondet midis programeve buxhetore, si më poshtë :

Në buxhetin e vitit 2024 janë parashikuar 15,000,000 lekë investime në Programin buxhetor AC102 Arsimit&Kujdesi Social. Shumën tjetër të nevojshme prej 10,000,000 lekë propozojmë të rishpërndahet/pakësohet nga shpenzimet kapitale të planifikuara në programin buxhetor AB102 Shërbimet Publike, Infrastruktura & Emergjencat Civile, produkti P452AAV "Investime të reja në infrastrukturën rrugore përfshirë shp. për supervizime&kolaudime,shpronësime" dhe të shtohen në programin buxhetor AC102 Arsimit&Kujdesi Social, në produktin P912AAO "Ndërtim i shkollës 9-vjeçare "22 Tetori" Berat dhe ambienteve të shërbimit dhe prishja e objektit ekzistues të shkollës "22 Tetori".

Në vitin 2025 propozojmë të shtohen me 80,000,000 lekë shpenzimet kapitale në programin buxhetor AC102 Arsimit&Kujdesi Social, në produktin P912AAO "Ndërtim i shkollës 9-vjeçare "22 Tetori" Berat dhe ambienteve të shërbimit dhe prishja e objektit ekzistues të shkollës "22 Tetori" dhe të pakësohen me 80,000,000 lekë shpenzimet kapitale në programin buxhetor AB102 Shërbimet Publike, Infrastruktura & Emergjencat Civile, produkti P452AAV "Investime të reja në infrastrukturën rrugore përfshirë shp. për supervizime&kolaudime,shpronësime".

Në vitin 2026 propozojmë të shtohen me 73,926,820.06 lekë shpenzimet kapitale të programit buxhetor AC102 Arsimit&Kujdesi Social, në produktin P912AAO "Ndërtim i shkollës 9-vjeçare "22 Tetori" Berat dhe ambienteve të shërbimit dhe prishja e objektit ekzistues të shkollës "22 Tetori" dhe të pakësohen me 73,926,820.06 lekë shpenzimet kapitale të programit buxhetor AB102 Shërbimet Publike, Infrastruktura & Emergjencat Civile, produkti P452AAV "Investime të reja në infrastrukturën rrugore përfshirë shp. për supervizime&kolaudime,shpronësime".

Ju faleminderit !

KRYETAR

Ervin DEMO

Sekretar i Përgjithshëm \_\_\_\_\_

Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Investimeve \_\_\_\_\_

Drejtorja e Integritit Europian dhe Projekteve \_\_\_\_\_

Drejtorja e Financës \_\_\_\_\_

Drejtorja Juridike \_\_\_\_\_



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA BERAT**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT**  
**DREJTORIA E TURIZMIT DHE AKTIVITETEVE**

**RELACION**

**PËR MANDATIMIN E BORDIT TË RI ARTISTIK KULTUROR TË BASHKISË BERAT**

Të nderuar Këshilltarë,

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1 shkronjat “b” dhe “d”, nenit 25, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, pikat 2 dhe 3 të nenit 28, të ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, të ndryshuar, ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, të ndryshuar ,sot kërkohet mandati i Anëtarëve të rinjë të Bordit Artistik Kulturor të Bashkisë Berat. Kjo strukturë kërkon vendimarrjen tuaj për funksionimin e saj me mandat 4 vjeçar.

Po ju njohim me objektin e veprimtarisë së Bordit Artistik Kulturor:

- Vlerësimi dhe mbështetja e projekteve që nxisin politikat parësore të jetës kulturore, artistike, sportive që kanë impakt në jetën e komunitetit e më gjerë.
- Vlerësimi dhe mbështetja e projekteve që prekin dhe aktivizojnë të gjitha grup moshat si edhe grupet e në jetën kulturore, artistike, sportive të qytetit.
- Vlerësimi dhe mbështetja e projekteve që synojnë dhe ofrojnë veprimtari elitare për komunitetin.
- Vlerësimi dhe mbështetja e aktiviteteve të përvitshme që kanë hyrë në traditën e një kalendarit kulturor artistik dhe sportiv.
- Vlerësimi dhe mbështetja e veprimtarive që synojnë njohjen dhe futjen në axhendat ndërkombëtare të aktiviteteve të kulturës , artit dhe sportit.
- Dhënia e mendimeve dhe propozimeve që ndihmojnë në hartimin dhe zbatimin e politikave kulturore të institucioneve pranë të cilave funksionojnë.
- Kjo strukturë ka karakter jo vetëm këshillimor, por edhe vendimarrësë, kur është fjala për kalendarin vjetor të veprimtarive.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT**  
**DREJTORIA E TURIZMIT DHE AKTIVITETEVE**

Bordi artistik i institucionit qëndror të artit dhe të kulturës ka detyrë të miratojë repertorin artistik vjetor të institucionit, në përputhje me politikën e ndjekur për artin dhe kulturën si edhe miraton projektet artistike, në përputhje me repertorin e vendosur. Ata propozojnë dhe japin mendime për hartimin dhe zbatimin e politikave kulturore e artistike, në mbështetje të talenteve të reja dhe vlerësimin e cilësisë artistike dhe performancave.

Bordet artistiko-kulturore duhet të kenë në përbërje personalitete të shquara në fushën e artit, kulturës dhe shkencës, të cilët nuk duhet të jenë të punësuar në institucionet pranë të cilave janë ngritur këto borde.

Anëtari i bordit artistik, përpara marrjes së çdo vendimi, është i detyruar të nënshkruajë një deklaratë, me anë të së cilës deklaron se nuk ka konflikt interesi, në kuptim të ligjit nr. 9367, datë 07/04/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, dhe të dispozitave të tjera ligjore në fuqi. Bordi artistik mbledhet sa herë gjykohet e nevojshme gjatë një sezoni artistik, jo më shumë se 6 (gjashtë) herë në vit. Masa e shpërblimit është 4.500 lekë kur zhvillojnë mbledhje. Efektet financiare, për shpërblimin e anëtarëve të keshillave artistiko-kulturore, të përballohen nga të ardhurat që krijon vetë institucioni.

Në mbledhjet e fundvitit miratohet lista e të gjitha projekteve artistike për zbatimin në vitin pasardhës.

Bordet artistiko-kulturore propozojnë dhe japin mendime për hartimin dhe zbatimin e politikave kulturore e artistike të institucioneve pranë të cilave funksionojnë, për mbështetjen e talenteve të reja dhe vlerësimin e cilësisë artistike.

Për probleme të veçanta, me karakter profesional, si dhe për kalendarin vjetor të veprimtarive, që do të zhvillohen nga institucionet, bordet artistiko-kulturore kanë të drejtë vendimmarrëse.

Ngritja dhe vazhdimësia e kësaj strukture është e domosdoshme dhe e dobishme për të shmangur gjykimet dhe vendimet individuale, qofshin këto edhe nga drejtues institucioneve, për projektet dhe veprimtari që promovojnë vlerat e trashëgimisë kulturore, për vlerësim të projekteve të përbashkëta kulturore etj.

Në ato Bashki që nuk ka trup të teatrit dhe estradës, bordi artistik ka në përbërjen e tij 5 anëtarë. Në këtë numër përfshihet edhe një nënpunës i Bashkisë, i cili drejton këtë strukturë në pozicionin e Kryetarit dhe nuk votohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT**  
**DREJTORIA E TURIZMIT DHE AKTIVITETEVE**

- 4 specialistët e tjerë të jenë nga fusha e kulturës, artit, letërsisë dhe sportit.
- Kandidaturat të jenë specialist me arsim të lartë.
- Të kenë mbi 5 vite eksperiencë pune.
- Të mos punojnë në institucionet në varësi të bashkisë, pasi krijojnë konflikt interesi duke votuar për projektet e tyre.
- Të jenë kandidatura përfaqësuese dhe të spikatura në kulturë, art, letërsi, sport.
- Kandidaturat të jenë alternativa me më shumë se një Kandidat.

Për secilën nga kandidaturat bashkangjitur po japim disa te dhëna profesionale të tyre:

**SEKTORI I MUZIKËS:**

1. **Fatbardh Dervishi** ka përfunduar studimet e larta në Institutin e Lartë të Arteve dhe në 1983 emërohet shef muzike dhe dirigjent i orkestrës simfonike në Pallatin e Kulturës “Margarita Tutulani”, Berat, post në të cilin punon për 20 vite me rradhë. Gjatë kësaj periudhe organizon dhe njëkohësisht udhëheq të gjitha aktivitetet kulturore artistike me karakter Lokal, Kombëtar dhe Ndërkombëtarë. Fatbardh Dervishi është një nga orkestruesit më me kontribut në qytetin e Beratit duke aranzhuar për të gjitha formacionet e mëdha dhe të vogla.
2. **Etleva Sylari** ka përfunduar arsimin e lartë në Akademinë e Arteve të Bukura në Tiranë, specialiteti Violinë në vitin 2015 si edhe punon aktualisht në shkollën e mesme Artistike “Ajet Xhindole”. Pjesëmarrja e saj tepër aktive ka rritur nivelin e zhvillimit cilësor të aktiviteteve brenda shkollës artistike dhe në qytetin e Beratit. Shfaq profesionalizëm të lartë në fushën e vet.

**SEKTORI I ARTEVE FIGURATIVE.**

1. **Llambi Mita** ka mbaruar në vitin 2003 shkollën e mesme Artistike “Ajet Xhindole” në degën e pikturës dhe në vitin 2007 ka mbaruar Akademinë e Arteve në Tiranë, Skulptore, Specialiteti, Materiale të përziera. Nga viti 2007 e deri tani është mësues në



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT**  
**DREJTORIA E TURIZMIT DHE AKTIVITETEVE**

shkollën e mesme artistike të qytetit. Ka qënë pjesmarrës në shumë ekspozita të organizuara nga Bashkia Berat si edhe është pjesë e shoqatës së Artizanëve të qytetit.

2. **Llambri Dëna** ka përfunduar Akademinë e Arteve të Bukura në Tiranë, në degën Skulpturë. Ka punuar si mësuese në Shkollën e Mesme Artistike Berat dhe ka kontribut të vyer në formimin e brezave të Skulptorëve. Vlerësimet dhe pjesëmarrjet në aktivitetet e zhvilluara në mbarë vendin kanë dëshmuar për punën, përkushtimin si edhe nivelin mjetë të lartë artistik. Llambri Dëna është figurë mjaftë e spikatur, si në formimin profesional, ashtu edhe në atë kulturor e intelektual.

**SEKTORI I LETËRSISË DHE ARTIT TË SKENËS:**

1. **Lefteri Kosova** e arsimuar në Fakultetin e Gjuheve të Huaja, Dega Frengjisht, Universiteti i Tiranës. Ka marrë pjesë në shumë trajnime në fushën e formimit pedagogjik dhe didaktik, shërbimet sociale dhe menaxhimit të projekteve. Ka filluar punë në vitin 1980 në shkollën e Mesme të Bashkuar në Tërpan dhe më vonë që prej 1983 e deri në daljen e saj në pension dha mësim në Gjimnazin “Babë Dudë Karbunara” lënda frëngjisht. Mbahet mend si një prej mësueseve më të dashura, më bashkëpunuese me kolegët apo dhe nxënësit e saj.
2. **Sokol Ferro**, ka mbaruar Fakultetin Filologjik, pranë Universitetit të Tiranës ku edhe është diplomuar në degën Gjuhe-Letërsinë vitet 1991-1995 dhe ka punuar si mësues i letërsisë në shkollën të ndryshme të qytetit duke bërë të mundur edukimin e shumë brezave. Gjatë punës ka spikatur me profesionalizëm, korrektësinë dhe përkushtimin në përcjelljen tek gjeneratat ndjeshmërinë për krijimtarinë dhe vlerësimin e figurave me kontributë në kulturë dhe art. Njëkohësisht punon edhe si gazetar nga viti 1998 në fushën e mediave vizive dhe të shkruar.
3. **Kozeta Nushi** në vitin 1992 ka përfunduar kursin e plotë të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike, në Universitetin Politeknik në degën Mekanike Tirane ku nga kjo shkollë ka marrë dhe titullin Inxhinierë Mekanike për Impiante, në vitin 2000 ka përfunduar kursin e plotë të Fakultetit Shkencave Natyrore, në Universitetin “Aleksander Xhuvani” Elbasan, në degën Matematikë-Fizikë dhe sot është Drejtuese e shkolles Profesionale “Siliano Bandilli” Gjatë punës ka spikatur me profesionalizëm, korrektësinë dhe përkushtimin në përcjelljen tek gjeneratat ndjeshmërinë për krijimtarinë dhe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT**  
**DREJTORIA E TURIZMIT DHE AKTIVITETEVE**

vlerësimin e figurave me kontributë në kulturë dhe art.

**SEKTORI I FISKULTURËS DHE SPORTIT:**

- 1. Igli Lacaj** i arsimuar në Akademinë e Edukimit Fizik dhe Sporteve “Vojo Kushi” Tiranë në vitet 1998-2002 dhe mësues i edukimit fizik nga viti 2002-2007. Përgjatë viteve 2007-2012 ka punuar si sekretar i klubit shumësportësh “Tomori” dhe aktualisht punon si mësues i lëndës së Edukimit Fizik në Gjimnazin “Kristaq Capo”. Për përcjelljen e vlerave në fushën sportive ka dhënë kontributin e tij edhe si anëtar i Këshillit Bashkiak të qytetit.
- 2. Klaudio Kumani** ka mbaruar shkollën tek Universiteti i Sporteve, Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes, Tiranë. Klaudio menjëhre është kthyer në Berat dhe ka filluar të japë mësim në shumë shkolla publike dhe jo publike të qytetit në lëndën e Edukimit Fizik. Klaudio ka një aftësi shumë të mirë të punuarit në grup, ka një aftësi të lartë analitike dhe drejtuese. Momentalisht është Mësues i Edukimit Fizik në shkollën publike “Ajet Xhindole”

Për çdo sektor janë propozuar dy kandidatura për votim. Fitues do të jenë ato kandidatura të cilat do të kenë më shumë vota.

**Silvana Merdani**  
*Drejtore e Turizmit dhe Aktiviteteve*





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI BASHKIAK BERAT

**PROJEKT-VENDIM**

**"MIRATIMI I PROJEKTIT TE NDERTIMIT TE SHKOLLES 9 – VJECARE"22 TETORI" DHE AMBJENTEVE TE SHERBIMIT, SI EDHE MIRATIMI I PRISHJES SE OBJEKTIT EKZISTUES SE SHKOLLES "22 TETORI "**

Mbështetur në ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” neni 7, neni 8, neni 9, pika 1.1, germa”a”,neni 23, neni 54, I ndryshuar, ligji 107/2014 “Per planifikimin dhe zhvillimin e territorit” I ndryshuar, ligj Nr. 8402, datë 10.9.1998 Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, I ndryshuar, këshilli Bashkiak Berat në mbledhjen e datës \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2024 :

**VENDOSI :**

1.Te miratohet projekti me objekt: "Miratimi i projektit te ndertimit te shkolles 9 – vjecare"22 Tetori" dhe ambjenteve te sherbimit, si edhe miratimi i prishjes se objektit ekzistues së shkolles “22 Tetori”Bashkia Berat”.

2Me ndjekjen e zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Kryetari i Bashkisë Berat, Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve Dhe Monitorimit Të Investimeve, Drejtoria E Mbrojtjes Civile, Transportit, Pronave dhe Shërbimeve dhe Drejtoria Juridike.

3.Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar.

**K R Y E T A R**

**I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ervin CECA**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BERAT

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT URBAN, LEJEVE DHE MONITORIMIT TË  
INVESTIMEVE

**Relacion:** "MIRATIMI I PROJEKTIT TE NDERTIMIT TE SHKOLLES 9 – VJECARE"22 TETORI" DHE AMBJENTEVE TE SHERBIMIT, SI EDHE MIRATIMI I PRISHJES SE OBJEKTIT EKZISTUES SE SHKOLLES “22 TETORI "

### Gjendja Ekzistuese

Shkolla publike 9- Vjecare ‘‘22 Tetori’’ me adrese Rruga Antipatrea ne Bashkine Berat eshte nje objekt i projektuar per te funksionuar si objekt arsimor ,i ndërtuar ne vitin 1965 ku ka funksionuar qe ne fillimet e tij si Shkollë Publike

Sipërfaqja e përgjithshme e territorit është rreth 2750 m<sup>2</sup>, ku 1700m<sup>2</sup> është hapësirë e jashtme dhe 1050 m<sup>2</sup> sipërfaqe e gjurmës së ndërtimit.

**Kapaciteti:** Në total shkollën e frekuentojnë rreth 650 nxënës. Ambjentet janë të shpërndara në 3 kate në një sipërfaqe ndërtimi total prej 2150 m<sup>2</sup>. Në këto ambiente ndodhen 15 klasamësimore, laborator informatike dhe palestër e mbyllur.

Tipi i strukturës është strukturë me mure mbajtëse.

Nga Inspektimi ne Ambientet e jashtme dhe te brendshme te kesaj godine u konstatuan keto problematika :

- a) Ne ambientet e brendshme te shkolles ,ne pjesen ku eshte hequr suvaja ,vihet re degradim i tullave qe jane pjese e struktures mbajttese te objektit
- b) Ne te tre katet vihete re prezenca e larte e lageshtise
- c) Soleta e katit te fundit(tarraca )si pasoje e lageshtise se madhe ka dale jashte funksionit dhe tejet e amortizuar .
- d) Demtime dhe prani e lageshtise ne soletat e katit perdhe .
- e) Demtime te shtresave te dyshemese ne tualetet te objektit
- f) Palestra eshte jashte perdorimit nga demtimet ne muraturen mbajttese dhe nga prezenca e larte e lageshtise .
- g) Demtime te rifiniturave nga termetet e rena dhe paslekundjet e tyre ne vitin 2019 .
- h) Ne fasaden e objektit ka prani lageshti ne murature
- i) Ne te gjithe objektin vihete re amortizimi i tullave dhe elementeve te tjere strukturore .

- j) Gjithashtu ne pjesen me te madhe te objektit vihet re prezence e larte e lageshtise e cila ka sjelle rritjen e amortizimit ,dhe ekspozimin e elementeve strukturore ndaj lekundjeve sizmike te termeteve te rena ne vitin 2019 .
- k) Objekti eshte projektuar sipas KTP-ve ne fuqi te asaj kohe ,te cilat kane mangesi te theksuara ne drejtim te llogaritjeve dhe koeficienteve te sigurise ,koeficienteve te rendesise ,faktorin e sjelljes ,duktilitetin etj . Nese mbajme parasysh kerkesat e kushteve te vjetra te projektimit jetegjatesia e projektimit e ketyre ndertesave me perdorim te gjere nga publiku eshte nga 50 deri ne 100 vite .







Foto te gjendjes ekzistuese

## **Prishja e objektit ekzistues**

Pikat ne te cilat jemi mbeshtetur dhe te cilat kane rezultuar ne prishjen e objektit ekzistues jane si me poshte:

### **AKTEKSPERTIZA E THELLUAR**

- a) Mbledhja e të gjithë dokumentacionit ligjor dhe teknik për objektin
  - i. Projekti arkitektonik
  - ii. Projekti konstruktiv
  - iii. Lejet e dhëna nga autoritetet përgjegjëse
  - iv. Studimi gjeologo-inxhinierik dhe dokumentacioni topografik të objektit
  - v. Studimi sizmik
- b) Evidentimi i ndryshimeve gjeometrike në strukturën e objektit gjatë kohës së shfrytëzimit
- c) Përditësimi gjeometrik i strukturës
- d) Mbledhja e dokumentacionit të zbatimit
- e) Katalogimi i dëmtimeve në objekt
- f) Gjykimi inxhinierik në bazë të raportit të llogaritjes së strukturës, të dokumentacionit të zbatimit dhe të shkallës së dëmtimit
- g) Konkluzionet për origjinën dhe shkallën e dëmtimit të objektit dhe përcaktimit të nivelit të dëmtimit nga aktekspertizat e mëparshme

### **ANALIZA E THELLUAR**

- a) Studimi i dokumentacionit gjeometrik dhe teknik te objektit pa dokumentacion teknik
- b) Studimi i strukturave sipas përcaktimeve të SSH EN 1998-3:2005:
  - i. Studimi gjeometrik
  - ii. Studimi i materialit
  - iii. Studimi i detajimeve
- c) Studimi i strukturave, që do të shoqërohet me kryerjen e testeve, me shkatërrim dhe pa shkatërrim, sipas përcaktimeve të dhëna në standardin shqiptar SSH EN 1998-3:2005, ose specifikimeve teknike dhe/ose standarde të tjera të barasvlefshme me të.
- d) Studimi Gjeologo inxhinierik
- e) Studimi Inxhiniero Sizmologjik
- f) Projekti stimulues bazuar ne kushtet ne fuqi
- g) Evidentimi dhe katalogimi i demtimeve

- h) Analiza lineare, sipas përcaktimeve të dhëna në standardin shqiptar SSH EN 1998-3:2005, ose specifikimeve teknike dhe/ose standardeve të tjera të barasvlefshme me të, të përshtatshme për tipin e strukturës. Ngarkimi sizmik të bëhet sipas procedurës së përcaktuar në standardin shqiptar SSH EN 1998-3:2005 ose specifikimeve teknike dhe/ose standarde të tjera të barasvlefshme
- i) Analiza Jo lineare sipas përcaktimeve të dhëna në standardin shqiptar SSH EN 1998, për tipin e strukturës
- j) Konkluzioni për performancën e godinës, sipas metodologjisë bazuar në standardin shqiptar për sizmicitetin dhe ngarkimin sizmik, sipas kushteve teknike dhe procedurave, sipas përcaktimeve në specifikimet teknike dhe/ose standardeve të tjera të barasvlefshme me standardin shqiptar për sizmicitetin
- k) Rekomandime për ndërhyrjet strukturale të nevojshme për kthim të strukturës konform kushteve teknike dhe përshtatjen sipas standardeve shqiptare ose specifikimeve teknike dhe/ose standardeve të tjera të barasvlefshme

## VLERËSIMI I GJENDJES AKTUALE TË STRUKTURES

### Hyrje dhe Parimet e Përgjithshme

Metodologjia e përgjithshme sipas rekomandimeve të shprehura në Eurokodin 8/3, dokumentet FEMA dhe ATC bazohet mbi këto etapa:

- Mbledhja e të dhënave ekzistuese për strukturën, historikun, praktikën e ndërtimit dhe projektimit në kohën kur është projektuar dhe realizuar objekti, tipologjia, klasifikimi, vlerësimi paraprak si edhe mbledhja e të dhënave mbi kriteret e projektimit sizmik të ndërtesës (në kohën e projektimit të saj);
- Identifikimi i të dhënave gjeometrike karakteristike për strukturën dhe detajet përkatëse (lloji dhe tipologjia e elementeve strukturore, përmasat karakteristike të elementeve të ndryshëm konstruktiv, themelet, elementet vertikale, soletat, traret, arkitraret, koloncinat, brezat si edhe armimi i tyre, armatura gjatësore dhe ajo terthore).
- Identifikimi i karakteristikave të materialeve, nëpërmjet provave laboratorike, analizës së materialeve, etj.
- Mbledhja e të dhënave mbi dëmtimet strukturore të tanishme ose të mëparshme (nëse ka), duke përfshirë riparimet e mundshme që janë kryer në kohë, historikun, gjendjen aktuale

- Rivlerësimi i ngarkesave të ushtruara në rastet kur ndërtesa shërben për qëllime të ndryshme nga ato të parashikuara në kohën e projektimit duke konsideruar edhe klasën e rëndësisë së ndërtesës. Vecanerisht janë vlerësuar objektet me nderhyrje në katet perdue, dhe ndryshimi i detsinacionit nga banim në shërbime etj.
- Vlerësimi strukturor nepermjet analizave lineare sipas kritereve të Eurokodeve
- Vlerësimi strukturor nepermjet analizave jolineare (përfshirë edhe vlerësimin e tabanit/themeleve nëse është e nevojshme)
- Vlerësimi i kapacitetit të elementeve strukturor
- Përfundime dhe rekomandime

### ***Parimet e përgjithshme***

Nevoja për riaftësim strukturor

Arsyet kryesore të kryerjes së vlerësimit strukturor të ndërtesave ekzistuese janë:

- jetëgjatësia e projektimit të ndërtesave (mosha e tyre)
- vlerësimet e sotme të rrezikut sizmik;
- ndryshimet në kodet e projektimit nga koha e ndërtimit deri sot;
- dëmtimet e ndryshme që kanë pësuar ndërtesat ndër vite.
- nderhyrjet arkitektonike të planifikuara



## Objektivat e projektit

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të kontribuojë në modernizimin, rritjen e standardeve funksionale dhe kapacitetit maksimal të nxenesve.

Vetë projekti synon të përmirësojë standardet përse i përket procesit të mesimdhënes, sigurisë, të optimizojë dhe të sigurojë një lëvizshmëri dhe aksesueshmëri efektive në përputhje me praktikën dhe standardet më të mira kombëtare dhe/ose ndërkombëtare.

Shkolla 9-vjeçare “22 Tetori” propozohet për ndërtim të ri në truallin e godinës kryesore. Shkollat e re do të ndërtohet me kapacitet për rreth 600 nxënës, për të plotësuar nevojat e komunitetit të zonës. Ajo do të përmbajë ciklin 9-vjeçar dhe parashkollor.

## Qëllimi i projektit

Qëllimi i këtij projekti është rindërtimi i një shkolle në të njëjtin vend ku gjendet shkolla ekzistuese, por njëjlla e objektit të ri do të ndryshojë duke marrë parasysh të gjithë hapësirat e nevojshme për mbarevajtjen e mesimit me një turn.



Planvendosja e objektit

## Projekti i propozuar

Shkolla e re është konceptuar si një shkollë që përfshinë të gjithë hapësirat e nevojshme për mbarëvajtjen e mësimin me një turn.

Si rrjedhojë njolla e shkollës së re është më e madhe ;

Sipërfaqe Parcele	2836.7 m <sup>2</sup>
Sipërfaqe gjurme	1302.67 m <sup>2</sup>
Koeficienti i shfrytëzimit të territorit	46 %
Sipërfaqe totale ndërtimi	5520.52 m <sup>2</sup>


Shkolla e re 22 Tetori parashikohet të zhvillohet në tre kate.

Funksionet pozicionohen linearisht përgjatë një aksi qendror i cili shërben si holl për shkollën. Ky aks ka drejtim levizje verilindje-jugperendim kurse funksionet përgjatë tij ku janë të pozicionuara klasat labororet dhe ambjejtet e tjera kanë orjentim veriperendim-juglindje, një orjentim me optimal përsa i përket diellit. Shkolla ka dy hyrje njëra lidhet me rrugën kryesore Antipatrea si dhe tjetra në rrugën që lidhet me katedralen të ndodhur në krah të saj.

Objekti përfshin 3 kate në të cilat janë shpërndarë funksionet e nevojshme si: palestër auditor, bibliotekë, klasa, hapësira ndihmëse dhe laborore në një sipërfaqe totale ndërtimi prej 5520.52 m<sup>2</sup>


## Kati gjysem nën tokë

Kati gjysem nën tokë është parashikuar të jetë parkim i cili ka aksesin kryesor nga rruga në lindje pasi janë në të njëjtë kuote. Parkimi ka një kapacitet prej 34 makinash dhe ka akses të kontrolluar. Gjithashtu në këtë sipërfaqe do të ketë ambiente shërbimi në funksion të Bashkisë përgjatë rrugës kryesore Antipatrea si dhe palestra dhe dhomat teknike.




## Funksionet ne katin perdhe do te jene :

1. Holli kryesor
2. Hapesira e palestres + Dhoma zhveshje
3. Salla per shume funksione
4. Dhome mesuesi
5. Bibloteke
6. Klase per femijet me aftesi ndryshe (PAK)
7. Laborator per muzike ,pikturë
8. Salle per pritje me prinderit
9. Oborr
10. Ne ambjentet e jashtme nje fushe sportive



## Funksionet ne katin e pare do te jene :


1. Holli
2. 10 klasa
3. Laborator biologjie
4. Laborator kimie
5. Salle per mesuesit
6. Sekretaria
7. Arkiva
8. Dhome mjeku



## Funksionet ne katin e dyte do te jene :

1. Holli
2. 8 klasa
3. Laborator fizike
4. Laborator Informatike
5. Drejtoria
6. Zv.Drejtori
7. Zyre Psikologu

Funksionet janë të pozicionuara përgjatë terraces së gjelbëruar e cila krijon një tjetër ambient rekreativ për shkollën



## Fasadat

Fasada e objektit të ri do të trajtohet me materiale tepër familjare për qytetin e Beratit. Materialet që ne propozojmë të përdorim për pjesën e fasadës do të jenë veshje me gurë natyrale lokale, suva të imet si më poshtë si edhe veshje me panele laminat të cilet do të jene imitacion druri dhe metali.

**VLERA E INVESTIMIT NE TOTAL ME TVSH ESHTË 442,834,097.06**

Pamje 3 dimensionale





**Përgatiti: Drejtori z.Lucjano Bojaxhiu**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT**

**DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE TRANSPORTIT PRONAVE DHE SHERBIMEVE**

**R E L A C I O N**

**“MBI MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË BERAT, SË BASHKU ME DOKUMENTACIONIN TEKNIKO - LIGJOR PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FAMILJEN E ZNJ. KRISTINA KOLA BANESA E TË CILËS ËSHTË DËMTUAR NGA ZJARRI, NGA FONDI I KUSHTËZUAR I BUXHETIT TË SHTETIT PER MBROJTJEN CIVILE VITI 2024 “**

**Të nderuar këshilltarë,**

Në datën 24.01.2024 nga zjarri i rënë u dëmtua një banesë ndodhur në Lagjen Uznove , Rajoni Nr 3, Bashkia Berat.

Pas arkivimit të kërkesës së Znj. Kristina Kola, date 25.01.2024 Komisioni i Emergjencave i ngritur me Urdhërin Nr. 88 datë 08.02.2024 të Kryetarit të Bashkisë shkoi në vendngjarje dhe në baze të konstatimit fizik, hartoi procesverbalin e dëmeve të shkaktuara, mbështetur në VKM Nr.329, date 16.05.2012 “Për kriteret për procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore “. Proces verbali i konstatimit u përcollë në Këshillin e Qarkut me shkresën Nr.886 Prot, datë 08.02.2024 për vlerësimin e dëmeve sipas ligjit. Komisioni i Ekspertëve të Këshillit të Qarkut, ka përfunduar vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në banesën e Znj. Kristina Kola dhe është përcjellë në Bashkinë Berat me Nr.166/1 Prot, datë 04.03.2024. Në mbështetje të preventivave të hartuara nga grupi i eksperteve dërguar në Bashkinë Berat rezultojnë dëmet:

<b>1. Në banesën e shtetasës Kristina Kola në vlerën</b>	<b>674936 lek .</b>
- Punime ndërtimore në vlerën	261136 lek
- Orendi dhe pajisje	413800 lek

Bazuar në dokumentacionin që disponojmë, në VKM Nr.329 datë 16.05.2012 shkronjën “ ç”, të pikës1, të kreut III; i propozojmë Këshillit Bashkiak të miratojë vlerën e ndihmës së menjëherëshme financiare për:

**Znj. Kristina Kola në vlerën 337468 leke**

*Ndihma financiare do të përballohet nga” Fondi i Kushtëzuar i Buxhetit të Shtetit për Mbrojtjen Civile” sipas përcaktimeve të VKM-së 414, datë 08.07.2021.*

**DREJTORI DECTP**

**Erlin Kuçi**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA BERAT**  
**DREJTORIA E BUJQESISE ADMINISTRIMIT TE PYJEVE, UJERAVE DHE**  
**SHERBIMIT VETERINAR**

Berat , më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2024

**RELACION**

**PËR MIRATIMIN PARAPRAK TË PLANIT TË MASAVE PARANDALUESE TE**  
**ZJARREVE VITI 2024**

Në zbatim ligjit nr. 139 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 115/2014 datë 31.7.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” si dhe ligjit nr. 107/2014 datë 31.7.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, Bazuar në ligjin nr 152, datë 21.12. 2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi”.

**1. Dokumentacioni dhe procedura e ndjekur.**

Specialistët e pyjeve pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Administrimi i Pyjeve , Ujërave dhe shërbimi veterinar- bashkia berat kanë hartuar planin e parandalimit dhe menaxhimit të zjarreve për vitin 2024.

Është ndërtuar skema e lajmërimit në rast zjarri

**Bashkëlidhur me këtë relacion do të gjeni:**

- 1. Kopje të planit të masave per parandalimin e zjarreve për vitin 2024.**
- 2. Për diskutim: Miratimin paraparak të planit të masave parandaluese të zjarreve për vitin 2024.**

**Pas diskutimit nga anëtarët prezentë propozojmë të meren vendimet:**

**1.Të miratojë planin e masave parandaluese të zjarreve për vitin 2024.**

2.Për zbatimin e këtij Vendimi dhe vazhdimin e procedurave të ngarkohet Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave.

Drejtori

Arjan Shkëmbi